



MARS 2018

Implikimet e liberalizimit të vizave për Kosovën

Pas një procesi të gjatë i cili kishte përfshirë përdorimin e gazit lotsjellës në sallën e Kuvendit nga ana e partisë opozitare Lëvizja Vetëvendosje! me qëllimin për të penguar punën e tij, marrëveshja për demarkacionin e kufirit më në fund është ratifikuar nga Kuvendi.¹ Për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme rreth demarkacionit të kufirit gjatë tre viteve të fundit, dhe pastaj të pamundësisë së Kuvendit të Kosovës për ta ratifikuar atë, Komisioni Evropian (KE) e ka lënë të papërfunduar liberalizimin e vizave. Demarkacioni i kufirit ishte vendosur si kriter për liberalizimin e vizave në vitin 2015, kur KE kishte nxjerrë raportin e tretë të progresit rreth dialogut të vizave.² ECMI Kosova në këtë artikull analizon lidhjen ndërmjet marrëveshjes për demarkacionin e kufirit dhe liberalizimit të vizave, si dhe kushtet që janë përcaktuara nga ana e BE-së për Kosovën, veçanërisht në lidhje me sundimin e ligjit. Përveç kësaj, gjithashtu shpjegon se nëpër çfarë procedurash duhet të kalojë vendi për të arritur udhëtimin pa viza në zonën Schengen. Më tej, ky artikull i hedh një vështrim perspektivës së ardhshme për liberalizimin e vizave për Kosovën pas miratimit të marrëveshjes për demarkacionin e kufirit, duke analizuar zhvillimet në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Krejt në fund, artikulli vë theksin në efektet e mundshme që mund të ketë një proces i tillë për komunitetet jo-shumicë në Kosovë.

Diskursi publik rreth liberalizimit të vizave

Retorika politike e kohëve të fundit në Kosovë rreth liberalizimit të vizave është zhvilluar në kontekstin e marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi. Strategjia e Zgjerimit të BE për Ballkanin Perëndimor, e nxjerrë së fundmi, vetëm se e ka rindezur këtë. Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, ka deklaruar gjatë vizitës së tij në Kosovë, më 28 shkurt 2018, se “çështja më themelore

¹ Dia Morina, ‘Kosovo Parliament Approves Montenegro Border Deal’, website *Balkan Insight*, 21-03-2018, <http://www.balkaninsight.com/en/article/xx-kosovo-parliament-approves-montenegro-border-deal-03-21-2018> (23-03-2018).

² N.N., ‘Reports’, ueb-faqja e *Ministrisë së Integritimit Evropian e Republikës së Kosovës*, <http://www.mei-ks.net/en/reports-506> (08-03-2018).

është ratifikimi i demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, pasi që lidhet me liberalizimin e vizave.”³ Përveç Junckerit, edhe zyrtarët e BE-së Federica Mogherini dhe Nataliya Apostolova e kanë përmendur demarkacionin e kufirit në ndërlidhje me liberalizimin e vizave, gjë që e bën atë një çështje shumë të rëndësishme dhe politike.⁴ Ky argument është përsëritur nga pothuajse çdo politikan aktiv në Kosovë. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Presidenti Hashim Thaçi dhe Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, që të gjithë kanë deklaruar se “ratifikimi i marrëveshjes kufitare do t’i mundësojë Kosovës të arrijë afatet për dhënien e regjimit pa viza brenda vitit 2018.”⁵ Përndryshe, para se të ratifikohej demarkacioni, ekspertë të integritimit evropian kishin deklaruar se për shkak të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian vitin e ardhshëm, në rast se nuk do të miratohet marrëveshja e demarkacionit në mars 2018, Kosova do të duhej të pres për liberalizimin e vizave deri në vitin 2020.⁶

Luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar

Ndërlidhja e votimit të demarkacionit të kufirit drejtpërsëdrejti me liberalizimin e vizave është shumë e thjeshtëzuar dhe afati kohor i përmendur duket të jetë shumë ambicioz. BE i ka vendosur Kosovës një kusht tjetër më sfidues, i cili është forcimi i sundimit të ligjit dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sipas raportit të fundit të progresit të BE-së, Kosova ka përmbushur katërmbëdhjetë nga pesëmbëdhjetë kërkesa në lidhje me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sa i përket kushtit fare të fundit, i cili është “krijimi i një mekanizmi për përcjelljen e hetimeve, vendimeve të formës së prerë dhe konfiskimeve për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit profilit të lartë”, Kosova ka përmbushur elemente të mjaftueshme.⁷ Kritika e vetme e mbetur është se “në mungesë të vendimeve të formës së prerë, numri i konfiskimeve mbetet i ulët”, dhe se “përcjellja e rasteve të mbetura për zgjidhje nga ana e gjyqësorit, transferimi i aseteve të sekuestruara dhe konfiskimin përfundimtar i tyre kërkojnë

³ Llazar Semini, ‘EU’s Juncker Urges Kosovo Solve Border Deal with Montenegro’, ueb-faqja e *New York Times*, 28-02-2018, <https://www.nytimes.com/aponline/2018/02/28/world/europe/ap-eu-balkans-eu.html> (05-03-2018).

⁴ N.N., ‘EU Representative in Kosovo: “Fight corruption, then visa liberalization”’, ueb-faqja e *Top Channel*, 20-10-2017, <http://top-channel.tv/english/eu-representative-in-kosovo-fight-corruption-then-visa-liberalization/> (05-03-2018).

⁵ Gazeta Express, ‘Veseli: Agreement with Montenegro opens the way for visa liberalisation’, website *Gazeta Express*, 16-02-2018, <http://www.gazetaexpress.com/en/news/veseli-agreement-with-montenegro-opens-the-way-for-visa-liberalisation-173620/> (05-03-2018), Gazeta Express, ‘Thaci: Demarcation to strengthen Kosovo sovereignty’, website *Gazeta Express*, 21-02-2018, <http://www.gazetaexpress.com/en/news/thaci-demarcation-to-strengthen-kosovo-sovereignty-173670/> (05-03-2018) and GazetaExpress, ‘Hoxha: Visa liberalization in 2018 if demarcation is ratified this week’, website *Gazeta Express*, 19-02-2018, <http://www.gazetaexpress.com/en/news/hoxha-visa-liberalisation-in-2018-if-demarcation-is-ratified-this-week-173656/> (06-03-2018).

⁶ Arbësa Ibrahim, ‘Nese Demarkacioni s’kalon ne mars s’ka viza deri me 2020-n’, ueb-faqja e *Zërit*, 07-03-2018, <http://zeri.info/aktuale/189401/nese-demarkacioni-skalon-ne-mars-ska-viza-deri-me-2020-n/> (07-03-2018).

⁷ Komisioni Evropian, *Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin: raporti i katërt i progresit për Kosovën* për përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave* (Bruksel, 2016).

vëmendje të qëndrueshme të autoriteteve.”⁸ Më herët, në tetor 2017, Përfaqësuesja Speciale e BE-së, Nataliya Apostolova, kishte deklaruar: “Asnjëherë nuk kam thënë se kriteri për luftën kundër korrupsionit është përmbushur, por se është bërë punë e mirë”.⁹

Duke se Kosova ishte në rrugë të duhur, por në fillim të shkurtit 2018, Katerina Lopo, përfaqësuese e Zyrës së BE-së në Kosovë, u kishte thënë pjesëmarrësve të konferencës *Kosova dhe procesi i liberalizimit të vizave* se “Kosova nuk është duke bërë përparim, dhe është bllokuar me demarkacionin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.”¹⁰ Duke qenë se të gjitha bisedimet janë përqendruar tek demarkacioni, BE-ja nuk ka qenë krejtësisht e qartë nëse demarkacioni i kufirit me Malin e Zi do të çonte drejtpërdrejtë tek liberalizimi i vizave, gjë që me sa duket nuk qëndron. Për më tepër, gjatë konferencës për *Kosovën, Presidenca e BE-së dhe Strategjia e Re për Ballkanin Perëndimor - Çfarë Mund Të Presim*, Apostolova u ka thënë pjesëmarrësve se “liberalizimi i vizave mund të diskutohet vetëm pas rezultateve konkrete në luftën kundër krimit dhe korrupsionit” dhe se “nuk është korrekte që të jepen data për liberalizimin e vizave”.¹¹ Me këtë deklaratë të fundit, BE nuk e bën të qartë nëse demarkacioni i kufirit do të çojë direkt në liberalizimin e vizave, ndonëse retorika e kohëve të fundit (e përfaqësuesve të BE-së) përqendrohet kryesisht në këtë çështje. Nëse kërkesa e fundit është përmbushur përfundimisht, si Parlamenti i BE-së ashtu edhe Këshilli Evropian do të duhej të votojnë përfundimisht. Vendimet për çështjet e vizave miratohen me shumicë të cilësuar, që nënkupton se një propozim duhet të marrë 228 nga 309 vota. Pasi të miratohet propozimi nga Parlamenti dhe Këshilli, akti i miratuar duhet të publikohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, gjë që zakonisht merr rreth tre javë. Regjimi pa viza zyrtarisht do të hyjë në fuqi njëzet ditë pas datës së publikimit të këtij akti.¹²

Liberalizimi i vizave dhe të drejtat e minoriteteve në Ballkanin Perëndimor

Para se të u jepej liberalizimi i vizave, të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor u ishte ofruar nga një udhërrëfyes me kushte të veçanta të përshtatur për ta. Liberalizimi i vizave i ishte dhënë Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi në korrik 2009, ndërkohë që Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina e kishin marrë dritën jeshile në dhjetor 2010. Këto vende kishin arritur të fitonin liberalizim të vizave brenda vetëm

⁸ Ibid, 7.

⁹ N.N., ‘EU Representative in Kosovo: “Fight corruption, then visa liberalization”’, ueb-faqja e *Top Channel*, 20-10-2017, <http://top-channel.tv/english/eu-representative-in-kosovo-fight-corruption-then-visa-liberalization/> (05-03-2018).

¹⁰ Gazeta Express, ‘EU Official: Kosovo has stagnated on visa liberalisation’, website *Gazeta Express*, 13-02-2018, <http://www.gazetaexpress.com/en/news/eu-official-kosovo-has-stagnated-on-visa-liberalisation-173591/> (06-03-2018).

¹¹ Gazeta Express, ‘Apostolova e thote qarte: S’ka date per liberalizimin e vizave’, website *Gazeta Express*, 27-03-2018, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/apostolova-e-thote-qarte-s-ka-date-per-liberalizimin-e-vizave-516776/> (27-03-2018).

¹² Iniciativa Evropiane për Stabilitet, ‘The EU decision-making process’, ueb-faqja e ESI, <http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=489> (09-03-2018).

1-2 vitesh pas miratimit të udhërrëfyesve të tyre të veçantë.¹³ Kosova, në anën tjetër, është në pritje për më shumë se 6 vjet. Menjëherë pas liberalizimit të vizave në vendet e lartpërmendura, ka pasur rritje të konsiderueshme të numrit të emigrantëve të Ballkanit në BE. Në vitin e parë pas liberalizimit, numri i azilkërkuesve nga Maqedonia ishte rritur për pothuajse 600%. Për të ilustruar këtë rritje, përderisa numri i azilkërkuesve maqedonas dhe serbë në Gjermani në vitin 2009 kishte arritur në gjithsej 690, ky numër ishte rritur në 7,444 në vitin 2010.¹⁴ Vetëm në vitin 2015, mbi 130,000 emigrantë të parregullt nga Shqipëria, Serbia dhe Kosova ishin azilkërkues në BE.¹⁵ Mungesa e integritit të minoriteteve në Ballkanin Perëndimor është një nga arsyet kryesore pse numri i azilkërkuesve nga Ballkani është rritur në mënyrë drastike gjatë viteve.¹⁶

Si pasojë e fluksit të emigrantëve nga Ballkani, BE u ka bërë presion shteteve në rajon që të ndalen me abuzimin e sistemit të azilit të BE-së. Dy shembuj të masave që kanë ndërmarrë qeveritë e Ballkanit për shkak të kësaj janë kontrollet e rrepta kufitare dhe revokimi i dokumenteve të udhëtimit, por kjo ka çuar në shkelje të raportuara të të drejtave të njeriut. Në Maqedoni, për shembull, janë raportuar raste të profilizimit etnik në kufi. Të drejtat e personave të përkatësisë Rome janë shkelur dukshëm për shkak të një ligji të ri i cili ka vënë në fuqi mundësinë që e drejta për të udhëtuar të u pezullohet personave vetëm nën dyshimin e të qenit azilkërkues potencialisht të dështuar.¹⁷ Gjithashtu, në Rumani kalimi i kufirit në mënyrë të paligjshme mund të çojë deri në dy vjet burgim.¹⁸ Madje Ministri i jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, kishte deklaruar më 2011 se “askush nga këto komunitete (d.m.th. Shqiptarët dhe Romët) nuk do të mund të largohet nga vendi nëse nuk kanë bileta kthyese, mjete jetese gjatë qëndrimit atje dhe nëse nuk mund të deklarojnë arsyen e udhëtimit.¹⁹ Këto përvoja të kohëve të fundit kanë treguar se liberalizimi i vizave mund të çojë në përjashtim edhe më të madh social kundër njerëzve që janë veçse të marginalizuar dhe kontribuon në shkeljen e të drejtave themelore në vend që të kontribuojë në avancimin dhe mbrojtjen e tyre.²⁰ Këto çështje bënë që BE-ja të ndryshojë politikat e saj të udhëtimit pa viza. BE-ja tani vë “theksin

¹³ Gunda Schumann, ‘Visa Liberalisation for Citizens of Kosovo – A Critical Analysis of the Current State of Play and Future’, *Südosteuropa Mitteilungen* 04-05 (2010) 23.

¹⁴ Simonida Kacarska, ‘Losing the Rights along the way: The EU-Western Balkans Visa Liberalisation’, *European Politics and Society* 16 (2015) 370.

¹⁵ Valbona Zeneli, ‘Migration, Brain Drain and the Western Balkans: What must be done to make life attractive enough at home to not see everyone go abroad?’, ueb-faqja e *The Globalist*, 27-07-2017, <https://www.theglobalist.com/european-union-migration-brain-drain-and-the-western-balkans/> (05-03-2018).

¹⁶ Florian Trauner & Emanuele Manigrassi, ‘When Visa-free Travel Becomes Difficult to Achieve and Easy to Lose: The EU Visa Free Dialogues after the EU’s Experience with the Western Balkans’, *European Journal of Migration and Law* 16 (2014) 125.

¹⁷ Ibid., 136-137.

¹⁸ Kacarska, ‘Losing the Rights along the way’, 371.

¹⁹ Ibid., 372.

²⁰ Trauner & Manigrassi, ‘When Visa-free Travel Becomes Difficult to Achieve and Easy to Lose’, 144 and Kacarska, ‘Losing the Rights along the way’, 364.

më shumë në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat themelore dhe përfshirjen sociale të grupeve të marginalizuara, në veçanti Romët.”²¹

Udhërrëfyesi i Kosovës

Kriteret e udhërrëfyesis për Kosovën janë të ngjashme me ato të udhërrëfyesve për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Dhënia e liberalizimit të vizave popullit të Kosovës me siguri do të çojë në një rritje të konsiderueshme të njerëzve që do të kërkojnë azil në njërin nga shtetet anëtare të BE-së. Historia e kohëve të fundit përfshin raste kur njerëz nga Kosova kanë kërkuar azil në vendet e BE-së mbi baza të rreme. Në vitin 2011, sipas autoriteteve boshnjake, 400 emigrantë kosovarë kishin kërkuar azil në BE si shtetas të Bosnje-Hercegovinës.²² Në vitin 2010 ka pasur raporte sipas të cilave shtetas të Kosovës kanë blerë pasaporta biometrike të Serbisë për një çmim deri në €10,000.²³

Regjistri civil në Kosovë akoma përballet me probleme. Për shkak të kësaj, njerëzit pa identifikim të duhur ende nuk do të jenë në gjendje të udhëtojnë në zonën Schengen kur të merret liberalizimi i vizave. Kjo është veçanërisht problematikë për Serbët e Kosovës në pjesën veriore, ku numri i përgjithshëm i të regjistruarve mbetet veçanërisht i ulët. Megjithatë, pasi të hiqet kufizimi i vizave do të bëhet më e fortë domosdoshmëria për regjistrimin e banorëve të veriut si shtetas kosovarë, për shkak të përmirësimit të lirisë së lëvizjes që do të sjellë kjo. Përveç kësaj, për shkak të zhvillimit të institucioneve të Kosovës në komunat veriore do të rriten kërkesat për letërnjoftime të Kosovës.²⁴ Prandaj, është me rëndësi kyçe që autoritetet e Kosovës të fillojnë procedurat e sigurimit të lehtë të qasjes në regjistrin civil të Kosovës për banorët e komunave të caktuara dhe për pjesëtarë të minoriteteve (për shembull, për Romët), në mënyrë që të mos shtohen më tej ndarjet brenda popullsisë.²⁵

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

²¹ Trauner & Manigrassi, 'When Visa-free Travel Becomes Difficult to Achieve and Easy to Lose', 125.

²² Simonida Kacarska, 'Losing the Rights along the way', 372.

²³ Gunda Schumann, 'Visa Liberalisation for Citizens of Kosovo', 33.

²⁴ Equal Rights for All Coalition, *The People in Between: The Future of Citizenship and Freedom of Movement of Kosovo Serbs and Other Non-Majority Communities* (2017) 11.

²⁵ Ibid.